



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 19.01.2015, me fillim në ora 10.00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Nahit Elshani**.

Kryesuesi Elshani – Fillimisht më lejoni të përshëndes Nënkryetarin e komunës z. Xhemali Haxhimustafa dhe stafin e tij, delegatët e pranishëm në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, monitoruesin e KDI-së, përfaqësuesit e mediave dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Propozimit për shpalljen e zonës së interesit publik për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Krushë të Madhe,
3. Shqyrtimi i propozimit për shpalljen e interesit publik për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale,
4. Shqyrtimi i Draft Marrëveshjes për mbulimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit,
5. Të ndryshme.

Rendi i ditës aprovohet pa vërejtje.

1. Procesverbali nga mbledhja e kaluar aprovohet njëzëri. .

2. Shqyrtimi i Propozimit për shpalljen e zonës së interesit publik për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Krushë të Madhe,

Kujtim Popaj, D. Gjeodezisë dhe kadastrës- Potencoj se kjo pikë ka të bëjë me shpalljen e interesit publik të komunës së Rahovecit ku parashihet që në këtë sipërfaqe që është përcaktuar nga ana e qeverisë komunale të bëhet ngritja e një impianti për trajtimin e ujerave të zeza dhe gjitha këto prona gjinden në zonën kadastrale Krush e Madhe afër lumit Drini i bardhë me një sipërfaqe diku rreth 4 hektar dhe janë prona komunale të pa shfrytëzuara dhe ne mendojmë se kjo zonë është mjaftë e përshtatshme për ngritjen e këtij impianti, këto prona komunale nuk kanë kurrfarë kontesti pronësorë.

Kryesuesi- Unë mendoj se ky impiante nuk do ti trajtoj vetëm ujërat e zeza të fshatrave Krushë e Madhe, Celinë, Brestovc, por do ti përfshij edhe Rahovecin dhe fshatrat tjera pse jo Drenovcin.

Selim Duraku- Lidhur me parcelat që drejtori i ceku se aty është një lumë dhe unë sa e di aty është rruga që e ndanë Krushen e Madhe dhe Krushen e Vogël pra kufiri administrativ me Prizrenin, dhe pyetja tjetër është se kjo parcelë 4 hektar a do të lihet vetëm për impiant apo keni edhe ndonjë projekt tjetër për shfrytëzimin e kësaj parcele, në këtë projekt a do të përfshihet e gjithë komuna e Rahovecit apo vetëm disa fshatra.

Kujtim Popaj- Unë e ceka edhe më parë se është zonë kadastrale e Krushës së Madhe, sa i përket se a do të përfshihet e gjithë komuna e Rahovecit në këtë projekt apo vetëm disa fshatra unë mendoj se aty janë ekspertët ata që e vlerësojnë se si do të jenë mundësit sepse e gjitha varet prej pozitës gjeografike të fshatrave.

Florije Boshnjaku- E falënderoj drejtorin në lidhje me këtë propozim vendim sepse mendoj se komuna jonë ka nevojë për impiant të ujërave të zeza, por pe shoh se është bërë një gabim tek propozimi në faqen e parë ku thotë se ky propozim hynë në fuqi në ditën e nesërme nga dita e marrjes së ti, unë e kam cek edhe ma herës se propozimet nuk hynë në fuqi në ditën e nesërme, ndërsa tek propozim vendimi që ka ardhur nga kryesuesi shkruan se ky vendim hynë në fuqi në ditën e miratimit nga kuvendi komunal, ne kemi than rregullisht se nuk mundet të hyjë në fuqi sepse i dërgohet MAPL pra së paku mbas 8 dite.

Kryesuesi- Është një udhërrëfyes administrativ që e ka përgatit asociacioni i komunave të Kosovës dhe precizohet shumë qartë aty vendimet edhe të kuvendit por edhe të Kryetarit.

Fatmir Iska- Është një propozim shumë i mirë por unë kam disa pyetje në lidhje me këtë pikë: a ka projekt të kësaj natyre dhe nëse ka sa është vlera totale e projektit dhe cila kompani do ta ndërtoj.

Kryesuesi- Projekt nuk ka sepse nuk ka vend, qëllimi është me pas një hapësirë ku mundemi me ju afruar donatorëve sepse jam i bindur se komisioni evropian këto vite të ardhshme do të ketë si prioritet trajtimin e ujërave të zeza, po ashtu edhe për projekt duhet të kemi mjete të mjaftueshëm sepse kesi lloj projektesh janë të kushtueshëm sepse kërkojnë standarde të bashkimit evropian.

Fatmir Iska- Unë sa e di në qeverisjen e kaluar ka qenë një projekt i cili ka kushtuar mjaftë dhe është bërë nga një kompani gjermane Holdering GmbH dhe vlera e projektit ka qenë 17.800 € unë besoj se ky projekt duhet të jetë në drejtorin e urbanizmit ose në drejtorin e shërbimeve publike, po ashtu e di se kemi pasur edhe një kontakt me një kompani Zvicerane me këtë projekt mundë të konkurrohet në disa kompani të Zvicerës të cilët kanë qenë ekspertë

në këtë fushë po ashtu mendoj se mundë të shkohet edhe në formën e kredisë afatgjate me një normë të interesit të volitshëm, po ashtu është përcaktuar edhe vendi se ku mundë të ndërtohet ky impiant dhe ku do të përfshihet e tërë komuna e Rahovecit, vlera përafërsisht mbas diskutimeve me ekspertë gjermanë ka qenë 14 milion €.

Kryesuesi- Kjo pikë e rendit të ditës do ti përcillet kuvendit me këtë rekomandim do të shikohet nëse janë kuotat dhe vendi i njëjtë ku është parapa mu ndërtua ky impiant edhe në projektin ekzistues që thoni ju se ekziston, kalojmë në pikën e radhës,

3. Shqyrtimi i propozimit për shpalljen e interesit publikë për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale, me ligj për dhënien e pronës komunale komuna duhet në fillim të vitit ta ketë listën e pronave të cilën mundet ti jep në shfrytëzim afatshkurtër apo afatgjatë dhe duke pas parasysh interesin e komunës në këtë rast dy parcela që janë diku përmbi fshatin Hoq e Madhe dhe që nuk janë në zonën e mbrojtur të Hoqës së Madhe është një propozim vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për ndërtimin e objekteve hoteliere kemi një të interesuar për këtë parcelë, pra së pari komuna duhet të merë vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone pastaj procedura tjera janë të ekzekutivit dhe komisioni për dhënien në shfrytëzim i ndjekë procedurat e shpalljes së ankandit.

Kujtim Popaj- Pra si e ceku edhe kryesuesi janë dy parcela diku përmbi Hoqës së Madhe është sipërfaqe e pa shfrytëzuar edhe pse në librat kadastral shkruan se është kullos, dhe ne për këtë vend kemi të interesuar për zhvillimin e biznesit të hotelierisë dhe unë besoj se me këtë komuna mundet të përfitoj sepse do të paguhet tatim për këtë pronë po ashtu do të hapen edhe vendet e reja të punës.

Fatmir Iska- Ne në seancën e kaluar kemi pasur pikë të rendit të ditës të kësaj natyre dhe kemi kërkuar që edhe opozita ta ketë një anëtar në atë komision, për deri sa nuk jemi pjesëmarrës ne si opozitë në atë komision në emër të këshilltarëve të aleancës ne nuk do ta përkrahim asnjë vendim të kësaj natyre sepse ne mendojmë se nuk ka edhe transparencë ky komision pa asnjë anëtar të opozitës.

Rexhep Oruçi- Mendoj se është një ide e mirë të shpallet kjo zonë si zonë për dedikimet e caktuara të zhvillimit të ekonomisë, por unë do të isha ndalur pak rreth formulimit të pikës unë mendoj se këtu nuk kemi të bëjmë aspak me interesin publikë interes publikë mendoj se është kur e shpallim një zonë të veçantë si për ndërtimin e impiantit, shkollave etj, dhe jo kjo e cila do ju jepet personave fizikë kjo s'ka të bëjë fare me interes të përgjithshëm, propozoj që ky formulim të modifikohet pak ma ndryshe.

Kujtim Popaj- Kjo është e rregulluar me ligj se çdo pronë që e japim qoftë për nevojat e kuvendit të komunës qoftë privatë janë në interes publikë dhe për atë arsye e kemi formuluar kështu.

Kryesuesi- Ne do të bisedojmë në mbledhjen e ardhshme për çështjen e komisionit që e ceku Fatmiri por unë sa e di kur është formuar ky komision opozita e ka lëshuar mbledhjen dhe për atë arsyeje nuk janë të përfshirë.

Fatmir Iska- Ne e kemi liruar atë ditë mbledhjen për shkak të statutit të komunës dhe jo për rendin e ditës të asaj mbledhje pra mos të keqkuptohemi por vetëm për pikën e cila ka qenë për statut të komunës.

Kryesuesi- Ju keni vepruar ndryshe e jo si thuani tani ju keni mundur ta lironi mbledhjen vetëm për pikën të cilën nuk jeni pajtuar dhe për pikat e tjera të ktheheni në sallë por ju nuk jeni kthyer fare dhe me atë e keni lënë të kuptohet se nuk keni qenë të interesuar të jeni as nëpër komisione.

Selim Duraku- Për të ushtruar një veprimtari hotelerie 2 hektar tok mendoj se janë shumë unë kisha me propozuar që këtë parcelë ta shfrytëzojnë 2 apo 3 kompani e jo vetëm njëra.

Kryesuesi- Nuk duhet të paragjykonim ne thamë se parcela është 2 hektar por askush nuk tha se do e merë një person, por nëse dikush ofron projekt që mundet të shfrytëzojë 2 hektarë dhe dëshiron të bëjë ndonjë hotel që nuk kemi në rajon me objekte përcjellëse pse mos ti jepet, mundë të kemi edhe 3 apo katër investues në atë parcelë, me vërejtjen që e dha Rexhepi e përcjellim këtë pikë për kuvend, pra e qesë në votim kush është për:7 për, kundra nuk ka abstenim nuk ka.

4.Shqyrtimi i Draft Marrëveshjes për mbulimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit.

Feim Fetoshi, Drejtor i shërbimeve Publike- Siç e dini në shumë komuna të Kosovës ka disa vite që realizohen këto lloj marrëveshje ka forma të ndryshme varësisht prej komunave ne jemi bazuar se si punon komuna e Shtimes për shkak se jemi edhe komuna e njëjtë për nga madhësia, në shumë komuna është bërë vetëm në mes të kryetarit dhe Këshillit të bashkësisë islame por kryetari ka vendosë që këtë marrëveshje ta bartën për votim tek kuvendi, esenca është e qartë që në rast të vdekjeve familjari të mos ketë brengën e procedurave të varrimit por me atë punë të mirët këshilli i bashkësisë islame, pra kjo marrëveshje bëhet mes këshillit të bashkësisë islame të Rahovecit dhe Kryetarit për gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit të përkatësisë islame, ne e dimë se në komunën e Rahovecit kemi pjesëtarë të përkatësive fetare tjera ortodokse dhe katolike por kryetari është i gatshëm që edhe me këto bashkësi të bëjë marrëveshje, shërbimet bazike që do të kryhen në rast të një rasti mortor të gjitha këto do të mbulohen me një pagesë prej 200 €, si ne edhe K.B.I. pajtohemi se me këtë shumë mundë të ja dalin, këtu përfshihet edhe informimi i mjekut për konfirmimin e vdekjes, po ashtu në marrëveshje i kemi caktuar edhe disa nene që përcaktojnë se si do të bëhet pagesa, pra çdo fund muaj K.B.I. bënë një raport komunës për rastet

e vdekjes bashkë me atë raportet do të jenë të bashkangjitur edhe raportet e mjekut dhe komuna do e bëjë pagesën mbas kësaj marrëveshje.

Florije Boshnjaku- Së duhet të kemi një akt normativ një rregullore për tu mbuluar këto shpenzime të varrimit ose një vendim të kuvendit dhe mbas kësaj kryetari i komunës lidhë marrëveshje me B.I. por kisha me propozua që para se të lidhet marrëveshja të konsultohen edhe me dy Shehlerë sepse siç e dimë në Rahovec ekzistojnë dy bashkësi islame sepse janë çështje të ndjeshme dhe me kalimin e kohës ne do të hasim në keqkuptim edhe me qytetarët, kemi rast që një qytetar është nga Rahoveci dhe varrosët në një komunë tjetër nuk është e potencuar se kush do ti paguaj shpenzimet, po ashtu duhet të jetë përveç logos së Komunës duhet të jetë edhe logoja e B.I. po ashtu tek neni 2 thotë se me 1 janar 2015 fillon zbatimi i marrëveshjes ndërsa në fund thotë se kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët nuk e kam të qartë këtë, po ashtu e kam një pyetje për drejtorin se nga cili kod do të sigurohen këto mjete, unë në parim pe përkrasi këtë marrëveshje.

Selim Duraku- Unë një propozim imami i Krushës së Madhe i kryen ritualet edhe në Krush të Vogël dhe ai nuk merë asnjë pagesë, i pyes anëtarët komisionit se a mundet të futet edhe Krusha e Vogël në këtë marrëveshje të jetë një ndiçmes për atë fshatë që është i prekur nga lufta.

Kryesuesi- kjo nuk ka të bëjë me hoxhallarë por ka të bëjë me territor të komunës së Rahovecit, Hoxhallarët munden të shkojnë të shërbejnë ku dëshirojnë ata, pra kjo marrëveshje vlen vetëm për territorin e komunës së Rahovecit.

Rasim Fazliu- Unë pajtohem me parafolësit sa i përket rregullave dhe ligjeve jam për tu plotësuar si duhet dhe të kalojë në kuvend dhe të jetësohet në komunën tonë sikurse në disa komuna tjera, unë e mbështesë këtë draft marrëveshje sepse me këtë ju dalim në ndihmë banorëve të komunës sonë.

Nënkryetari- Me keqardhje ma te madhe e them se jemi mësuar vetëm të marrim shembuj nga diku, ne pe marrim modelin por nuk pe dimë se a po na bie përshtati neve, ju si diskutues tash në këtë rast jeni të thirrur tash që të jepni mendime të cilët do të jenë në harmoni me interesat e qytetarëve, kemi të bëjmë me një vendim që ka me nxjerrë kuvendi i cili do të jetë në interes të qytetarëve të Rahovecit, unë kisha me thanë se nuk kemi nevojë me nënshkrua marrëveshje me asnjë bashkësi tjetër as ortodokse as katolike, të shkojmë me familjarë me një shërbim të veçantë ose në qendrën për punë sociale ose diku tjetër të sillet certifikata e vdekjes dhe vërtetimi i mjekut dhe ti lëshohet pagesa familjarëve. Kuvendi punon me vendime dhe rregullore kuvendi nuk punon me marrëveshje, sa i përket numrit vdekjeve në komunën tonë unë kam marrë informata nga shërbimi i ofiqarisë se për vitin 2014 kemi pasur 156 vdekje në nivel komune.

Fatmir Iska- Në vitin e kaluar unë kam propozuar që të jetë një rregullore që do ti mbulojë këto shpenzime të varrimit, por jo në këtë formë si ka ardhur në KPF, një marrëveshje që përcakton vetëm interesin e dy subjekteve që kanë një interes të caktuar për një gjë dhe në këtë rast kemi marrëveshjen e kryetarit me B.I. në Rahovec, sipas mendimit tim kjo marrëveshje nuk është dashur të vije fare ne KPF e as në kuvendë komunalë që të trajtohet, kjo çështje duhet të rregullohet me rregullore e mbas rregullore pason marrëveshje mes kryetarit dhe B.I. në Rahovec dhe në këtë mënyrë edhe kuvendi do ta kishte përkras, unë pajtohem në disa çështje me nënkryetarin që komuna jonë ka disa specifika të veçanta që nuk mundesh ta përshkruash me disa komuna tjera, ne pajtohemi të gjithë se ekziston një B.I. mirëpo de fakto në Rahovec ekzistojnë dy B.I. dhe bashkësia tjetër ka një pjesëmarrje ma të madhe se në këtë rast që po nënshkruhet kjo marrëveshje me kryetarin, shërbimet kryhen nga të dy B.I. dhe në bazë të kësaj marrëveshje unë shohë se bashkësia e tarikateve fare nuk është konsultuar e as njoftuar lidhur me këtë marrëveshje, kjo marrëveshje vetëm ka filluar të zbatohet në disa raste të vdekjeve të fundit që kanë ndodhur janë kryer shërbimet nga B.I. e Rahovecit, ne vetëm jemi para aktit të kryer, unë jam që ti ndihmohet qytetarëve të komunës sonë por jo në këtë mënyrë dhe pse të mos shkojmë ne me një vërtetim të vdekjes çdo familjari që i ndodhë ndonjë rast i vdekjes të vije në komunë dhe mjetet ti derdhen në llogarinë e tij deri sa të zgjidhet një zgjidhje pak a shumë e përhershme, unë jam kundër kësaj marrëveshje në kesi formë.

Rexhep Oruçi- Unë mendoj se marrëveshja është një akt i vullnetit në mesë të kryetarit të komunës dhe B.I. sipas mendimit tim gjithsesi kësaj marrëveshje duhet ti paraprijë një vendim i kuvendit sepse është akt obligativë ku duhen të përfshihen disa pika ma specifike dhe pastaj kryetari i komunës në bazë të këtij vendimi bënë marrëveshje në këtë rast me B.I. por mendoj se vendimi duhet të jetë gjithëpërfshirës ku do të përfshihen edhe komunitetet tjera fetare, neni 2 në këtë marrëveshje bie ndeshë me nenin 9, ku thuhet se mbulimi i shpenzimeve për shërbime të varrimit sipas kësaj marrëveshje në asnjë mënyrë nuk ndërlihet me pagesën e anëtarësisë, ne kemi pas raste në qytet nëse nuk e ka paguar qytetari anëtarësinë kurrfarë shërbime prej bashkësisë islame nuk ka mundur ti shfrytëzojë, nëse B.I. i merë 200 € le të i kryej shërbimin se ma shumë nuk do të kushtojë.

Feim Fetoshi- Do i përgjigjem pyetjeve që i kanë parashtruar këshilltarët, po ja nisi nga Rexhep Oruçi absolutisht keni të drejtë se shërbimi duhet të jetë për të gjithë tek ai nen që shkruan se nuk ndërlihet me çështjen e pagesës së anëtarësisë çështja është se kryetari të komunës apo kuvendit të Rahovecit nuk i intereson çështja e marrëdhënieve në mesë B.I. dhe individëve, krejt që dëshirojmë ne të arrijmë me këtë marrëveshje me B.I. është që qytetarët mos të kenë atë ditë brengën e varrimit, unë nuk pajtohem me fatmirin kur tentoj ti ndajë bashkësinë dhe tarikatet por

pajtohem me nënkryetarin që tha se nuk është mirë ne të hymë në këto gjëra, të gjitha këto shërbime që ceken në nenin 2 janë shërbime për gjithë pjesëtarët që i takojnë përkatësisë fetare islame qoftë të tarikateve e qoftë tjerëve këtu nuk po bëhet fjalë për formën e të ritualit se në çfarë forme do të falet. Sa i përket mjeteve kryetari ka vendosë se këto të paguhet nga subvencionet, sa i përket pyetjes që e bëri zj. Florije se çka bëhet nëse vdesë dikush që është i Rahovecit dhe varroset diku tjetër, neni 1 tregon qartë të gjithë ata që varrosen në territorin e komunës së Rahovecit, sa i përket pyetjes që u tha se ne nuk mundemi të imitojmë komunat tjera, unë e thashë në fillim se ne jemi bazuar vetëm në formën e Shtimes por nëse e merreni marrëveshjen e Shtimes ju keni me pa se ka shumë ndryshime nga marrëveshja e jonë por ne vetëm si bazë e kemi marrë 200 €, është e vërtetë unë kam dëgjuar se B.I. po e zbaton këtë formë por unë besoj se në kuptimin juridik asgjë nuk na pengon neve që të marrim vendim që zbatimi të paguhet nga 1 janari me retroaktivitet.

Kryesuesi- Ne nuk mundemi të lejojmë të kaloj një marrëveshje në këtë formë sepse ne nuk jemi si komuna e Shtimes sepse ne jemi një komunë ma specifike sepse tek ne ka edhe të komunitetit ortodoksë dhe katolikë dhe nuk duhet të lejojmë që nesër ne të bëhemi cak i medieëve, nëse nuk mundet të rregullohet tash rregullorja atëherë i japim një hapësirë 1 ose 2 muaj drejtorisë që ta përgatit rregulloren ndërsa në mbledhjen e kuvendit le të silltet një vendim ku do të autorizon kryetarin e komunës të bëjë marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare që ekzistojnë në komunën e Rahovecit.

Feim Fetoshi- Ne si Drejtoria e shërbimeve publike vetëm i kemi dalë në ndihmë kryetarit të komunës në kuptimin teknik, po ashtu edhe në kuptimin juridik e kemi dërguar në zyrën ligjore që ta shikojë se a është e bazuar në ligj sepse kjo ka qenë një premtim i kryetarit të komunës, dhe kjo askund nuk figuron se është përgjegjësi e drejtorisë së shërbimeve publike. Edhe unë pajtohem me ju që të merret një vendim dhe në bazë të atij vendimi kryetari të bëjë marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare që veprojnë në komunën tonë.

Kryesuesi- Si rekomandim për kuvendë, kjo marrëveshje nuk duhet të vije fare në kuvendë por duhet të vije një vendim ku i pareshe për të gjitha komunitetet fetare në komunën e Rahovecit.

Florije Boshnjaku-Mitrovica e ka një rregullore dhe është mirë të shikohet përafërsisht dhe të përgatitet sa me shpejtë që në kuvend të dalim edhe ne të përgatitur, po ashtu duhet të njoftohet edhe B.I. dhe të ju tregojmë se shpenzimet e varrimit do të paguhet në mënyrë retroaktive prej 1 janarit kurë të miratohet rregullorja.

Rasim Fazliu- Ne po flasim për të ju shërbyer qytetarëve dhe kurrësi për të nxitur urrejtje në mesë njëri tjetrit edhe unë jam pro asaj që të bihet një vendim, mirëpo unë jam kundër asaj që mbasi ti vdes dikujt ndonjë anëtar i familjes ne ti themi bjere vërtetimin e akt vdekjes dhe do i merë paret për shpenzimet e varrimit, ne duhet ti dalim në ndihmë njerëzve në atë ditë që të mos brengosen.

Fatmir Iska- Ne duam me marrë një vendim por unë nuk do të pajtohem me këtë vendim për shkak formës, ju dëshironi me marrë një vendim dhe ta autorizoni kryetarin me bë një marrëveshje marrëveshjen të cilën pe kundërshtojmë dhe çka do të arrijmë me këtë asgjë.


Kryesuesi- Mbledhja e radhës kuvendit parashihet të mbahet me 30 Janar për shkak të afateve ligjore që duhet me shpërnda materialin, në mbledhje të kuvendit do të ketë edhe 3 pika shtesë sot nuk i kemi këtu por ato kanë kaluar nëpër komitete të KPF kemi të bëjmë me dy rregullore dhe një statut të QKMF, dhe për të tria këto akte normative ligjore nesër do të mbahet debat publikë me qytetarët dhe të njëjtat do ti kalojnë kuvendit për aprovim.

Kujtim Popaj- Desha të sqarohem me Florijen dhe rekomandimet që i dhatë ju për shkak se unë duhet të përgatis materialin për kuvendë, të nderuar delegatë unë e posedoj një komentare të vitit 2014 i cili e komenton ligjin për dhënien në shfrytëzim të tokave dhe këtu janë procedurat të cilat duhet të ndiqen për të dhënë një tokë në shfrytëzim, dhe po ashtu Florija tha se vendimi i Kryetarit nuk mundet të hy në fuqi nga dita e nesërme sepse është e paligjshme, por unë e kam propozimin si është mbas komentarit në nenin e 6 të këtij komentari shkruan se ky propozim hynë në fuqi nga dita e nesërme e marrjes, pra unë ju kam referuar këtij komentari. Pronat që jepen në shfrytëzim për persona fizikë dhe juridikë është afati 15 ditë, për pronat komunale për nevojat tona nuk ka nevojë për kurrfarë afati.

Kryesuesi- Ju faleminderit për pjesëmarrje me kaçë e përfundojmë mbledhjen e KPF. Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 11.45.

Procesmbajtësi,
Skender Hamza

Kryesuesi
Nahit Elshani



-III- Nr. I prot. 2107 Më 13.02 2018
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC